

Fillimi > Krujë

Sekuestrohen 58.5 kg kanabis në Krujë, arrestohet pronari. Si ishte përshtatur banesa për përpunimin dhe shitjen e drogës

21 Tetor, 2022 13:50



Madhësia e tekstit: - +

- Sekuestrohen 58.5 kilogramë lëndë e dyshuar narkotike kanabis në proces tharjeje dhe municion luftarak.
- Kapet në flagrancë dhe vihet në pranga pronari i banesës ku u gjet edhe municion luftarak.
- Shërbimet e Policisë, në vijim të kontrolleve të përbashkëta me OSHEE-në, Krujë, si dhe bazuar në inteligjencë informative, kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Fokusi”, si rezultat i të cilit u vu në pranga shtetasi:

-V. S., 23 vjeç, banues në Derven, Krujë, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.

Në banesën e 23-vjeçarit, shërbimet e Policisë konstatuan 2 ambiente (dhomë dhe magazinë), të përshtatura për përpunimin, tharjen dhe përgatitjen për shitje të lëndës narkotike kanabis. Gjatë kontrolleve të imtësishme në këto ambiente, u gjetën dhe u sekuestruan në total, 58.5 kg lëndë e dyshuar narkotike kanabis në proces tharjeje, si dhe gjatë verifikimeve, në bashkëpunim me punonjësit e OSHEE-së, u konstatua se këto ambiente furnizoheshin me energji elektrike përmes lidhjeve të paligjshme. Në vijim të operacionit, u ushtrua kontroll dhe në ambiente të tjera të kësaj banese dhe u gjet e u sekuestrua edhe municion luftarak.

Vijojnë veprimet hetimore për dokumentimin e plotë të veprimtarive kriminale të shtetasit V. S.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprime të mëtejshme

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'iu aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: kanabis kruje

TË NGJASHME

- 


EMRAT/ Shpërndanin kokainë dhe kanabis, arrestohen dy persona në Vlorë, çfarë zbuloi policia

22 Tetor, 2022
- 


U arrestua në "shtëpinë e barit", dënohet me 8 muaj burg 31-vjeçari shqiptar në Angli, pas dënimit e pret dëbimi

22 Tetor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

- 

Vrasja e Indrit Ndoj në Fushë-Krujë/ "E lamë të gjallë", zbardhet dëshmia e dy vëllezërve: Situata na doli nga kontrolli, jemi penduar

22 Tetor, 2022
- 

Fshehën 70 mijë euro ilace kontrabandë në shtëpi, çifti nga Saranda kundërshton kontrollin e banesës

22 Tetor, 2022
- 

U gjet i pajetë në kanal, policia reagon për vrasjen e 34-vjeçarit në Fushë Krujë: Arrestohen dy vëllezërit Janë konfliktuar për...

22 Tetor, 2022
- 

EMRI/ Aksident i rëndë në Gjirokastër, polici kufitar godet për vdekje me makinë 12-vjeçarin (VIDEO)

22 Tetor, 2022
- 

Vrasja e 34-vjeçarit në Fushë Krujë, zbulohet identiteti i autorëve (EMRAT)

22 Tetor, 2022
- 

Nis hetimi për tokat e Buftit në Sarandë, dy biznesmenë nën akuzë

22 Tetor, 2022

KATEGORIA VIDEO

- 

VIDEO/ Broja fiton penallti, Chelsea ndëshkon United në fund

22 Tetor, 2022
- 

VIDEO/ Problem shëndetësor apo u përjashtua? BBC zbulon detaje nga dalja misterioze e ish-liderit kinez nga Kongresi i Partisë Komuniste

22 Tetor, 2022
- 

VIDEO/ Diaz "bën" Messin në sytë e Berlusconi, Milani spektakolar ndaj Monzës në San Siro

22 Tetor, 2022
- 

Erzeni rikthehet "i magjishëm", mund Tiranën në "Elbasan Arena", një penallti "thyen" bardheblutë

22 Tetor, 2022
- 

"PD e opozita duhet të bashkohet në protesta të fuqishme", Sallanji: Jemi të vonuar! Fajin e kanë ata që kanë marrë përsipër të drejtojnë pjesët e PD

22 Tetor, 2022
- 

EMRI/ Aksident i rëndë në Gjirokastër, polici kufitar godet për vdekje me makinë 12-vjeçarin (VIDEO)

22 Tetor, 2022